



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2022, merr këtë

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të “Kompania e Re Dardania - Arbëria” SHPK (qirambajtje), Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Deshishku.
- II. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, ka këto karakteristika:
  1. Parcela kadastrale nr. 3125-6, sip. 1178, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-03125-6, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Kompania e Re Dardania - Arbëria” SHPK (qirambajtje), Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Deshishku, me destinim interes i përgjithshëm publik-shfrytëzim publik dhe infrastrukturë rrugore.
  2. Ndërsa prona e paluajtshme që do të jepet në këtë këmbim, është pjesa e parcelës kadastrale, nr. 3125-2, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-03125-2, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës, me destinim ndërtim, sipas Planit të hollësishëm “Kodra e Trimave 1”.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues të hollësishëm “Kodra e Trimave 1”, e miratuar me Vendimin, 01 nr. 350/05-0118238/17, të dt. 22.05.2017, si dhe në kuadër të Planit zhvillimor urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 035-181427, të dt. 24.09.2013.
- IV. Pas shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.



- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
  - kopjet e planit dhe
  - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-463/01-236756/22, më 28.10.2022

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina



## Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit me Vendim për Caktimin e Kushteve Ndërtimore 05 Nr.350/02-18947/21 dt.01.03.2021 ka dhënë pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr.3125-2 Zona Kadastrale Prishtinë , Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-03125-2 në pronësi të : Komuna e Prishtinës, me destinim ndërtim me parcelën kadastrale nr.3125-6 Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-03125-6 në pronësi të: Kompania e Re Dardania-Arbëria Sh.p.k (qirambajtje), Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Dëshishku, me destinim interes i përgjithshëm publik-shfrytëzim publik dhe infrastrukturë rrugore.

Vendimi për inicimin e këmbimit të parcelës së tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit Planit Rregullues të Hollësishëm "Kodra e Trimave 1" miratuar me Vendimin 01 nr.350/05-0118238/17 dt.22.05.2017 si dhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.035-181427 dt.24.09.2013, pjesa e parcelës nr.3125-2 Zona Kadastrale Prishtinë shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim ndërsa parcela kadastrale nr.3125-6 Zona Kadastrale Prishtinë me destinim interes i përgjithshëm publik-shfrytëzim publik dhe infrastrukturë rrugore.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

